



Buletini mujor

Janar 2026



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu dhe delegacioni shoqërues me Presidentin e ECA-s, z. Tony Murphy

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu zhvillon vizitë pune në Gjykatën Evropiane të Audituesve, takohet me Presidentin e ECA-s, z. Tony Murphy

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu, së bashku me një delegacion shoqërues, zhvilloi në datë 21 janar 2026 një vizitë zyrtare pune pranë Gjykatës Evropiane të Audituesve (*European Court of Auditors - ECA*) në Luksemburg.

Në kuadër të kësaj vizite u zhvilluan disa takime zyrtare, ndër të cilat, një takim i posaçëm me Presidentin e ECA-s, z. Tony Murphy, si dhe me anëtarë të Dhomës III. Gjatë diskutimeve u trajtuan çështje që lidhen me metodologjitë bashkëkohore të auditimit, programet e punës për vitin 2026, si dhe mundësitë për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve.

Duke vlerësuar bashkëpunimin me Gjykatën Evropiane të Audituesve, veçanërisht në kuadër të programeve të praktikës profesionale, ku KLSH ka pasur deri më tani 22 përfaqësues pjesëmarrës, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, u shpreh se forcimi i mëtejshëm i këtij bashkëpunimi do të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve audituese dhe në përvetësimin e praktikave më të mira evropiane.

Diskutimet vijuan me prezantime nga departamente të ndryshme të ECA-s, të cilat u fokusuan në fusha me interes të përbashkët, strategjitë e "Inteligjencës Artificiale", si dhe në planifikimin strategjik afatmesëm dhe afatgjatë.

Gjykata Evropiane e Audituesve, e cila udhëhiqet përmes motos "Gardianët e Financave të BE-së" është një nga bashkëpunëtorët më afatgjatë të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Si një anëtar aktiv i INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, në përmbushje të plotë të të gjitha parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të bashkëpunimit ndërinstitucional, KLSH vijon prej vitit 2014 të forcojë bashkëpunimin me ECA-n, një nga institucionet më të rëndësishme të Bashkimit Evropian në fushën e auditimit të jashtëm publik.



Për më shumë se një dekadë, auditues nga departamente të ndryshme të KLSH-së kanë mundur të jenë pjesë aktive e strukturave të ECA-s nëpërmjet internshipeve 5-mujore. Kjo praktikë e konsoliduar prej vitesh ka kontribuar në krijimin e një gjenerate audituesish të rinj, të cilët përcjellin në KLSH eksperiencën dhe formimin e tyre profesional sipas standardeve dhe praktikave më të mira evropiane duke shtuar vlerë në punën e institucionit.

Gjykata Evropiane e Audituesve është themeluar si institucion i auditimit të jashtëm të BE-së në vitin 1975 dhe filloi punën në tetor 1977. Misioni i ECA-s është të përmirësojë mënyrën se si menaxhohen financat e BE-së dhe të ofrojë siguri të pavarur nëse paratë janë mbledhur dhe shpenzuar sipas rregullave.



Study Visit by the President and Delegation
of the Albanian SAI

Vizita e Kryetarit të KLSH-së në Gjykatën Turke të Llogarive për forcimin e bashkëpunimit institucional



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, gjatë takimit me Presidentin e Gjykatës Turke të Llogarive, z. Metin Yener

Më 9 janar 2026, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu, së bashku me delegacionin shoqërues zhvilloi një vizitë zyrtare pranë Gjykatës Turke të Llogarive (*Turkish Court of Account - TCA*), në kuadër të forcimit të marrëdhënieve institucionale bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar mes dy institucioneve.

Gjatë vizitës u vlerësuan punët e kryera në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit për të forcuar bashkëpunimin midis dy SAI-ve dhe u vendos të rritet shkëmbimi i përvojave, mbështetja teknike dhe bashkëpunimi, sidomos në fushat e reja të auditimit.

Qëllimi kryesor i kësaj vizite ishte intensifikimi i bashkëpunimit profesional të deritanishëm, veçanërisht në fushën e auditimeve të sigurisë dhe shkëmbimit të praktikave më të mira ndërkombëtare. Gjatë takimit me Presidentin e Gjykatës Turke të Llogarive, z. Metin Yener dhe përfaqësues të TCA-së, u diskutua mbi përvojat, sfidat aktuale dhe nevojën për ngritjen e kapaciteteve profesionale në auditimin e sistemeve komplekse dhe të ndjeshme të sigurisë.

Në kuadër të vizitës zyrtare, delegacioni i KLSH-së zhvilloi gjithashtu një vizitë pranë agjencisë "Havelsan", një nga institucionet kryesore teknologjike në Turqi, ku u njoh me zgjidhje të avancuara në fushën e sigurisë kibernetike, sistemeve të informacionit dhe mbështetjes teknologjike për proceset e auditimit.

Kjo vizitë kontribuoi në forcimin e marrëdhënieve ndërmjet dy institucioneve homologe duke konkretizuar mundësitë për bashkëpunim të mëtejshëm në projekte të përbashkëta, trajnime profesionale dhe shkëmbim ekspertize, në funksion të rritjes së cilësisë dhe efektivitetit të auditimit publik.

Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit, datë 03.10.2024, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Gjykata Turke e Llogarive do të shkëmbejnë eksperiencë në fushën e auditimit të jashtëm të pavarur dhe kontrollit financiar shtetëror, në auditimet e performancës, përputhshmërisë, teknologjisë së informacionit, si dhe në analizën e të dhënave etj. Gjithashtu, është parashikuar kryerja e projekteve të përbashkëta kërkimore për tema me interes të përbashkët, organizimi i konferencave, seminareve, takimeve të punës etj.



BULETINI STATISTIKOR

JANAR – GUSHT 2025

KLSH ka publikuar "Buletin Statistikor" për periudhën janar - gusht 2025, gjatë së cilës janë kryer dhe evaduar 55 misione auditimi, në vlerësim të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, performancës, teknologjisë së informacionit dhe ndjekjes së statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në periudha të mëparshme. Auditimet e kryera kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit në 108 subjekte në nivele të ndryshme të qeverisjes, si: institucione qendrore, ministri dhe agjenci (përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre), njësi të vetëqeverisjes vendore, drejtori të përgjithshme të administrimit fiskal, si dhe shoqëri aksionere me kapital shtetëror në të cilat shteti zotëron mbi 50% të aksioneve, apo projekte me financim të huaj.

Gjatë periudhës janar - gusht 2025 janë dhënë 148 rekomandime mbi gjetje me efekte negative në buxhetin e shtetit, për vlerën totale 2,404,623 mijë lekë, nga të cilat: dëmi ekonomik vlerësuar 112,257 mijë lekë, menaxhimi joefektiv i fondeve në vlerën 2,292,366 mijë lekë.

Vlera e efekteve financiare me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e shtetit është konstatuar 57% në fushën e shpenzimeve dhe 43% në fushën e të ardhurave.

Në fushën e shpenzimeve, peshën më të madhe (90%) e zënë shkeljet e konstatuara gjatë procedurave të prokurimit dhe zbatimit të punimeve/kontratave në vlerën 57,445 mijë lekë (likuidime për punime të pakryera, moslogaritje e kostove përfundimtare të shërbimit të projektimit, punime jo në përputhje me specifikimet teknike etj).

Ndërsa në fushën e të ardhurave, peshën më të madhe (rreth 96% e totalit të të ardhurave) e zënë të ardhurat nga aktiviteti doganor, si pasojë e mosarkëtimit të detyrimeve doganore; pagesa detyrimesh doganore në import për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kuadrin ligjor, vlerësime të gabuara të importeve dhe deklarimeve të artikujve, përjashtim i padrejtë nga pagimi i tvsh-së dhe trajtim i gabuar i shkeljeve doganore. Gjithashtu, problematika janë evidentuar në të ardhurat e munguara nga administrimi i pasurisë shtetërore dhe marrëdhëniet kontraktuale me palët e treta, në shumën prej 1,472 mijë lekë. KLSH ka evidentuar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave, shpenzimeve dhe në përdorimin e fondeve publike në vlerën totale 2,292,366 mijë lekë, nga të cilat:

- 1,768,832 mijë lekë në fushën e të ardhurave (ose rreth 77% e totalit), kryesisht në të ardhurat e qeverisjes lokale për çështje që lidhen me detyrime për taksat dhe tarifatat vendore (ose rreth 31% e totalit të të ardhurave), mostarifimit/përlllogaritjes së gabuar/mosaplikim të kamatëvonesave për përdorimin e pronave të bashkisë nga subjektet private (ose rreth 32% e totalit të të ardhurave); dhe detyrime të paarkëtuara për zjarre apo veprimtari të kundraligjshme, si: prerje drurësh, gurë dekorativë etj., rreth 35% e totalit të të ardhurave.
- 523,534 mijë lekë në fushën e shpenzimeve (ose rreth 23% e totalit) si rezultat i shkeljeve të konstatuara përgjatë procedurave të prokurimit dhe zbatimit të punimeve/kontratave në vlerën 253,698 mijë lekë, si dhe shkelje të disiplinës buxhetore, lidhur me likuidimin e shpenzimeve në vlerën 123,240 mijë lekë.

108

subjekte të
audituar

112 257

mijë lekë dëm
ekonomik

2 292 366

mijë lekë efekte
negative

Dëm ekonomik

● **64 039 mijë lekë** në fushën e shpenzimeve

● **48 218 mijë lekë** në fushën e të ardhurave

Menaxhim joefektiv

● **523 534 mijë lekë** në fushën e shpenzimeve

● **1 768 832 mijë lekë** në fushën e të ardhurave

Në fushën e shpenzimeve

57%

Në fushën e shpenzimeve

23%

Në fushën e të ardhurave

43%

Në fushën e të ardhurave


77%



REKOMANDIMET

1034

Rekomandime totale



Pranueshmëria e masava sipas llojit

Masa organizative
583/584 masa

99%

Masa disiplinore administrative
184/184 masa

100%

Shpërblim dëmi
47/47 masa

100%

Përmirësime ligjore
4/4 masa

100%

Menaxhim joefektiv
99/99 masa

100%

Total
919/920 masa

99%

PËRMIRËSIME LIGJORE



Në fushën e sigurisë kibernetike, në lidhje me hartimin e metodologjisë mbi identifikimin e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, në të cilën të përfshihet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit si operator bashkëpërgjegjës për infrastrukturën e qendëruara: Mbështetur në metodologjinë për identifikimin e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, të hartohen propozimet për ndryshimet ligjore të nevojshme. Gjithashtu, të ndërmerren nisma për ndryshime ligjore dhe rregullatore, me qëllim përcaktimin e qartë të rolit dhe përgjegjësisë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për menaxhimin e regjistrave të të dhënave, duke siguruar mbrojtjen efektive ndaj kërcënimeve kibernetike.




Në fushën e administrimit të pronave të sekuestruara, me qëllim unifikimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore dhe ngritjen e një grupi pune për rishikimin dhe propozimin e ndryshimeve të dispozitave kundërshtuese në këto akte: Strukturat drejtuese, për përmirësimin e situatës së krijuar, të ngrënë grupe pune për analizimin e problematikave në drejtim të saktësisë dhe cilësisë së raportimit të treguesve të kontratave të qirasë apo enfitotezës, si dhe të ndërmarrin një nismë ligjore për përmirësime në drejtim të të drejtave që duhet të kenë njësitë monitoruese ndaj subjekteve qiramarrëse të pronës shtetërore, si dhe të drejtave që duhet të kenë degët e shoqërive publike në prefektura ndaj njësitë të monitorimit të kontratave.

Publikohet Raporti i Zbatimit të Rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2024 (pjesa II)

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka publikuar raportin e "Zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme" (pjesa II). Nga verifikimet e kryera për 125 auditime, lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, rezultoi se janë dhënë gjithsej 4348 rekomandime, nga të cilat janë pranuar plotësisht dhe pjesërisht 4294 masa ose 99% dhe nuk janë pranuar 54 rekomandime, ose rreth 1% e tyre. Raporti mund të aksesohet i plotë në faqen e internetit www.klsh.org.al.

Procesi për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, inicimi dhe zbatimi i masave korigjuese nga subjektet e audituara jep një informacion të detajuar mbi vlerën e shtuar që sjell puna e KLSH-së në administrimin e financave publike dhe njëherazi jep garanci për profesionalizmin, pavarësinë dhe objektivitetin e institucionit. Konsolidimi i një mekanizmi efektiv i verifikimit sistematik dhe raportimit të zbatimit të rekomandimeve i lejon jo vetëm KLSH-së, por dhe palëve të treta, Kuvendit, Qeverisë etj., të sigurojnë në vijimësi një informacion të plotë lidhur me veprimet e ndërmarra nga ana e subjekteve të audituara për hartimin e dokumenteve strategjike apo për iniciativa për ndryshime ligjore, administrative dhe organizative. Skema dhe gasja e përdorur për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve synojnë të prodhojnë indikatorë të konsoliduar institucional sa i takon pranueshmërisë dhe zbatueshmërisë së rekomandimeve, duke mundësuar në këtë mënyrë rritjen e mbikëqyrjes nga ana e Kuvendit ndaj Ekzekutivit, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë së menaxhimit të fondeve publike.



TREGUESIT KRYESORË

4348 REKOMANDIME TË LËNA GJITHSEJ



Nga verifikimet e kryera për 125 auditime, lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, rezultoi se janë dhënë gjithsej 4348 rekomandime për subjektet e audituara.

2989 MASA TË ZBATUARA DHE NË PROCES, 70%



Nga verifikimi, lidhur me masat e pranuar, rezultuan 2989 masa (rreth 70%) e tyre të zbatuara plotësisht, pjesërisht ose në proces zbatimi. 1598 masa janë zbatuar plotësisht (rreth 37%), 645 masa zbatuar pjesërisht (rreth 15%), 746 në proces zbatimi (rreth 17%).

4294 REKOMANDIME TË PRANUARA, 99%



Nga verifikimet e kryera, lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, rezultoi se nga 4348 rekomandime të dhëna gjithsej, 4294 rekomandime janë pranuar (rreth 99% e totalit) dhe nuk janë pranuar 54 rekomandime ose rreth 1% e tyre.

1305 MASA TË PAZBATUARA, 30%



Për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar", 1305 masa ose 30% e tyre, si dhe për masat e "zbatuara pjesërisht", KLSH ka rikërkuar zbatimin e plotë të tyre. Ndërsa, për masat me status "në proces zbatimi", inkurajohet përsheptimi i procesit për zbatimin e plotë të tyre.



2386
Masa
organizative



1142
Masa
disiplinore



717
Efekte financiare
(në numër)



76
Masa
administrative



27
Përmirësime
ligjore

43
Auditime
të kombinuara

37
Auditime
financiare

24
Auditime
përputhshmërie

13
Auditime
performance

6
Auditime
tematike

Auditimi i përputhshmërisë në Avokaturën e Shtetit

KLSH ka përfunduar auditimin e përputhshmërisë në Avokaturën e Shtetit (ASH). Ndër gjetjet kryesore të auditimit, për periudhën 01.01.2023 deri në 31.12.2024, janë si më poshtë:

1. Në lidhje me vendimet e Arbitrazhit të fituara nga shteti shqiptar, në regjistrat elektronikë (Excel) rezultoi se janë 7 vendime, nga të cilat, 4 vendime janë të fituara gjatë vitit 2024. Sipas këtyre vendimeve, RSH duhet të rimburohet për kosto të tribunalit dhe shpenzime të përfaqësimit në vlerën 8,971,593 euro, 1,565,791 USD dhe 108,551 GBP, ose e shprehur në një monedhë të vetme 10,473,572 euro si dhe 6,821,710 euro dëmshpërblim. Në total, 17,295,282 euro të shpenzuara nga buxheti i shtetit, të ndara këto ndërmjet institucioneve të ndryshme, përfshirë MF, MIE, APD, MBZHR dhe AKUK.

Vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar bëhen të zbatueshme në Shqipëri pas njohjes së vendimit nga Gjykata e Apelit.

Nga këto 7 vendime, janë njohur nga Gjykata e Apelit Tiranë, vetëm 2 vendime:

- Çështja ICC Case No. 20564/EMT/GR (iniciuar nga viti 2014), me vendimin nr. 131, datë 03.05.2023 të Gjykatës së Apelit Tiranë (kërkuar MIE), ku Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka vendosur që pala paditëse "H. srl" duhet t'i paguajë penaltitete për vonesat Shqipërisë në shumën 6,821,710 euro dhe 325,000 USD.

- Vendimi i dytë i njohur nga Gjykata e Apelit i përket çështjes ICSID ARB/14/26 (iniciuar nga viti 2014) "A. A." sh.p.k., A. N., shoqëria "C. s.r.l.", me nr. 969, datë 25.11.2024, ku pala paditëse duhet t'i paguajë penaltitete për vonesat Shqipërisë, 3,269,938.71 euro.

Mosrimbursimi i vlerave të vendosura nga vendimet e Gjykatave të Arbitrazhit në favor të Shqipërisë në buxhetin e shtetit, në dy çështjet të cilat janë njohur edhe nga Gjykata e Apelit, konsiderohen të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën totale 10,091,648.7 euro dhe 325,000 USD, veprime në kundërshtim me Kodin e Procedurës Civile.

2. Në lidhje me çështjet në Gjykatat e Arbitrazhit Ndërkombëtar dhe vendimet e tyre ku shteti shqiptar është pala humbëse, deri në dhjetor 2024, rezultojnë 4 çështje, me efekte financiar në një vlerë totale 180,125,882 euro, nga të cilat, kosto të tribunalit dhe përfaqësimit janë 11,580,103.86 euro, vlerë e cila gjithashtu do të paguhet nga qeveria shqiptare.

Përsa i përket vendimeve të humbura nga RSH, vetëm një prej tyre është njohur nga Gjykata e Apelit, me vendimin nr. 49, datë 04.05.2021, konkretisht: Çështja ICC Case no. 22676/GR me palë paditëse GBC, iniciuar prej 2017. Pala e Paditur (MIE&AKBN, Alb Petrol). MIE dhe AKBN detyrohen t'i paguajnë paditësit vlerën 12,577,852.1 USD si dëmshpërblim monetar për shkelje të detyrimeve të Licencës së Marrëveshjes së Cakranit, Gorishtit dhe Ballshit. MIE dhe AKBN detyrohen t'i paguajnë paditësit 292,760 USD dhe 14,451.68 euro, me interes me normë 5%, e cila llogaritet nga data e vendimit deri në kryerjen e plotë të pagesës.

Prej datës së njohjes deri në periudhën e auditimit (prill 2025) nuk është marrë asnjë masë nga MIE dhe AKBN, për njohjen e këtij detyrimi dhe planifikimin në buxhetin përkatës për shlyerjen e tij, duke e vendosur shtetin shqiptar para një risku tjetër në dëm të buxhetit të shtetit, atë të interesave për 4 vite, të cilat të përlllogaritura nga grupi i auditimit prej datës së vendimit 06.07.2020 deri në 31.12.2024, vlera e pritshme e interesave është: 65,871 USD dhe 2,890.4 euro, ose e shprehur në një monedhë të vetme 60,776 euro, vlerë që përbën efekt negativ në buxhetin e shtetit.

3. Në lidhje me çështjet në proces apo të ndërprera në Gjykatat e Arbitrazhit Ndërkombëtar, 4 çështje janë të përfunduara, 2 janë çështje të pezulluara pa zhvillime nga ana e palës paditëse, dhe 2 janë në proces. Efekti negativ financiar i shpenzimeve gjyqësore, paguar nga buxheti i shtetit si palë e paditur për këto çështje (të pezulluara, të përfunduara dhe në proces) është 1,949,063 euro.

4. Nga ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në Avokaturën e Shtetit, për vitin 2023, rezultoi se janë shqyrtuar 47 çështje që lidhen me Shqipërinë për 75 kërkesa. Në këto çështje, kërkuarit kanë kërkuar shpërblime financiare prej rreth 2 miliardë lekë, ndërsa Gjykata pranoi shpërblime në vlerën e 29 milionë lekë ose 279 mijë euro. Në 18 vendime u konstatuan shkelje nga ana e shtetit shqiptar, ndërsa në 16 vendime kërkesat janë shpallur të papranueshme.



a) Nga përpunimi i të dhënave sipas regjistrave elektronikë të ASH-së, rezultoi se vendime të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, të cilat kanë marrë formën përfundimtare gjatë vitit 2023 janë 23, nga të cilat, të ekzekutuara brenda vitit 2023 janë 14 me një vlerë dëmshpërblimi 10,416,942 lekë dhe 68,166 lekë interesa për 5 vendime të likuiduara jashtë afatit 3-mujor në dëm të shtetit shqiptar.

b) Në lidhje me vendime të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, të cilat kanë marrë formë të prerë në vitin 2023 dhe janë kryer pagesat në vitin 2024, rezultojnë të jenë 9, me një vlerë dëmshpërblimi 21,263,173 lekë, nga të cilat, 37,396 lekë janë interesa për pagesa jashtë afatit 3-mujor.

c) Për vendime të GJEDNJ-së, të cilat kanë marrë formë përfundimtare në periudhën 2019-2021, por të ekzekutuara gjatë vitit 2023, rezultojnë të jenë 2 vendime (datë 26.01.2023) me një vlerë dëmshpërblimi 4,018,746 lekë, nga të cilat, 369,741 lekë janë interesa për pagesa të kryera jashtë afateve ligjore, konkretisht: Vendimi i datës 21.04.2021/Strazimiri kundër Shqipërisë dhe Vendimi i datës 17.09.2019/Prizreni kundër Shqipërisë.

Për vitin 2024, shteti shqiptar ka ekzekutuar gjithsej 31 vendime kundër Shqipërisë duke akorduar shpërblim dëmi në vlerën 30,355,446 lekë dhe në vlerë totale 30,403,545 lekë, nga të cilat, 48,009 lekë janë interes i paguar ndaj gjyqfituesve për vonesa në kryerjen e pagesës. Nga 31 vendime të ekzekutuara, 9 prej tyre janë të mbartura nga viti 2023.

Pra, në total për periudhën 2023-2024, janë paguar jashtë afatit 3-mujor, 19 vendime të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë në shkelje të nenit 19/4 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar, "Afatet e ekzekutimit nga institucionet përgjegjëse", të cilat kanë sjellë një efekt negativ financiar në dëm të buxhetit të shtetit në vlerën 485,916 lekë.

d) Nga auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve GJEDNJ në ASH, për vitin 2024, rezultoi se:

GJEDNJ ka dalë me 49 vendime për 67 kërkesa. Në këto çështje, kërkuarit gjatë gjyqimit kanë kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerë financiare prej 5,601,036.064 (pesë miliardë e gjashtëqind e një milionë e tridhjetë e gjashtëmijë e gjashtëdhjetë e katër) euro, ndërsa Gjykata ka pranuar në total një shpërblim dëmi në vlerën 212,600 euro.

5. Avokatura e Shtetit në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse (Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financës dhe Këshilli i Ministrave) nuk ka arritur ende të zgjidhë dhe të ekzekutojë vendimet e GJEDNJ-së në 6 çështje kundër Shqipërisë, të cilat kanë një vlerë dëmshpërblimi 17,968,650 euro, ku vetëm çështja "Sh." përbën 75 % të këtij detyrimi (rreth 13.3 milionë euro) me një vendim të datës 28.05.2018.

Në lidhje me 3 vendimet e GJEDNJ-së, të cilat kanë marrë formë përfundimtare në vitin 2024, dhe konkretisht: "I. s.r.l kundër Shqipërisë", me vendim përfundimtar të GJEDNJ, datë 05.03.2024 dhe afat për pagesën e shpërblimit të drejtë brenda datës 05.06.2024; kërkesa "Z. kundër Shqipërisë", me vendim përfundimtar të GJEDNJ, datë 11.06.2024 dhe afat për pagesën e shpërblimit të drejtë në vlerën 60.000 euro brenda datës 11.12.2024; kërkesa "M. dhe S. F. B. N. V. kundër Shqipërisë", vendim përfundimtar datë 16.10.2024 dhe afat për pagesën e dëmshpërblimit brenda datës 16.01.2025; edhe pse ASH ka dërguar pranë Kryeministrisë kërkesat për ekzekutimin e këtyre vendimeve, së bashku me projekt-VKM-të përkatëse, Vendimi i Këshillit të Ministrave, që duhet të miratohej brenda 30 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës së Avokaturës së Shtetit, nuk është miratuar, duke dalë përtej afateve (mbi 5 muaj).

Faturat e Arbitrazhit




Ministria e Financave, si në raportet vjetore 2023 dhe 2024, ashtu edhe në evidencat e borxhit, nuk paraqet dhe nuk ka llogaritur në asnjë moment, vlerën e interesave mbi shumat e përcaktuara në vendimet e GJEDNJ-së apo të Arbitrazhit Ndërkombëtar kundër Shqipërisë, edhe pse janë në tejkalim të afateve të përcaktuara. Këtë informacion nuk e disponon as Avokatura e Shtetit. Këto interesa, të cilat do të llogariten mbi dëmshpërblimin 17,968,650 euro (vlerat e vendimeve përfundimtare të GJEDNJ-së, ende të pa ekzekutuara) do gjenerojnë dëm në buxhetin e shtetit, veçanërisht vendimet e GJEDNJ-së, ku afatet janë të mirëpërcaktuara dhe ka ende vendime të cilat kanë më shumë se 7 vite jashtë afateve për ekzekutim.

Vendimet e Arbitrazhit të fituara nga RSH



Vendimet e Arbitrazhit të humbura nga RSH



Vendime të GJEDNJ-së, të mbartura në vite dhe të pa ekzekutuara



KLSH nënshkruan dy marrëveshje bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile

Në kuadër të rritjes dhe forcimit të bashkëpunimit me grupet e interesit, ndër të cilat përfshihen edhe organizatat e shoqërisë civile, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) ka nënshkruar së fundmi dy marrëveshje bashkëpunimi.

Në datë 27.01.2026, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, z. Sotiraq Hroni, duke rikonfirmuar vijimin e angazhimit me IDM. Kjo marrëveshje fokusohet në interesin publik për rritjen e transparencës, forcimin e integritetit, luftën dhe parandalimin e korrupsionit, si dhe rritjen e llogaridhënies në menaxhimin e financave publike, duke theksuar nevojën për një qasje gjithëpërfshirëse të shoqërisë në funksion të një qeverisje të mirë dhe efektive nga institucionet publike.

Marrëveshja e dytë e bashkëpunimit u nënshkrua më 29.01.2026 me organizatën "Faktoje.al", përfaqësuar nga Drejtuesja Ekzekutive, znj. Klodiana Kapo. Kjo marrëveshje synon bashkëpunimin ndërmjet KLSH-së dhe "Faktoje.al" në kuadër të projektit "Truths Beyond Numbers", me mbështetjen e programit MATRA të Ambasadës së Holandës në Tiranë.



Misioni i Auditimit të BE-së zhvillon takim në KLSH mbi menaxhimin e Reformës dhe Facilitetit për Rritje (RGF)



Më 28 janar 2026, në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, përfaqësuesit e Misionit të Auditimit të Komisionit Evropian zhvilluan një takim për të diskutuar mbi menaxhimin e Reformës dhe Facilitetit për Rritje (Reform and Growth Facility - RGF). Takimi kishte si qëllim kryesor të shqyrtonte rolin e KLSH-së në monitorimin e fondeve dhe në garantimin e një sistemi të fortë kontrolli të brendshëm.


Përfaqësuesit e institucionit prezantuan praktikat e tyre të auditimit dhe përfshirjen në planifikimin e reformave, duke treguar përvojën dhe ekspertizën në mbikëqyrjen e fondeve publike.

Gjatë takimit u diskutuan procedurat e auditimit të ndjekura nga KLSH, mekanizmat e kontrollit dhe sfidat kryesore që lidhen me vlerësimin e fondeve të RGF-së.

Përfaqësuesit e KLSH-së ndanë shembuj konkretë të auditimeve të kryera dhe mënyrën se si monitorohen zbatimet e reformave, duke theksuar rëndësinë e transparencës dhe llogaridhënies në çdo hap të procesit.

Misioni i Komisionit Evropian shprehu interes të veçantë për njohuritë dhe përfshirjen e institucionit, duke vlerësuar rolin kyç të Kontrollit të Lartë të Shtetit si garant i integritetit të fondeve publike.

Takimi përforcoi bashkëpunimin ndërinstitucional dhe nxori në pah rëndësinë e rolit të KLSH-së për një menaxhim transparent të fondeve. Ai u konsiderua një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë së auditimeve dhe forcimit të besueshmërisë së institucioneve shqiptare në përballjen me sfidat e reformës dhe menaxhimit të fondeve evropiane.



Takimi i Këshillit të Evropës për prezantimin e projekteve mbi forcimin e qëndrueshmërisë ndaj korrupsionit dhe pastrimit të parave

Këshilli i Evropës prezantoi zyrtarisht më 30 janar 2026 dy projekte të reja bashkëpunimi "Forcimi i qëndrueshmërisë së sektorit publik kundër korrupsionit" dhe "Lufta kundër pastrimit të parave në Shqipëri", të cilat do të mbështesin agjendën e reformave të Shqipërisë në luftën kundër krimit financiar. Prezantimi i projekteve u bë gjatë një takimi në Tiranë në të cilin morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë nga Këshilli i Evropës, Ambasada Zvicerane, institucionet publike shqiptare dhe organizata të shoqërisë civile. Me ftesë të Këshillit të Evropës, pjesëmarrës në këtë takim ishte edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit. Takimi shërbeu si një platformë për prezantimin e objektivave strategjikë të projekteve, fushave kryesore të ndërhyrjes, si dhe të mbështetjes që pritet t'u ofrohet institucioneve shqiptare në fushat e antikorrupsionit, luftës kundër pastrimit të parave dhe forcimit të mekanizmave të rikuperimit dhe menaxhimit të aseteve.

Diskutimet u fokusuan në aspektet kyçe të përpjekjeve të Shqipërisë për forcimin e kuadrit antikorrupsion dhe të luftës kundër pastrimit të parave.

Pjesëmarrja e vazhdueshme e KLSH-së në aktivitete të tilla, që synojnë promovimin e forcimit të mekanizmave kundër korrupsionit, dëshmon angazhimin e institucionit për të kontribuar aktivisht në përmirësimin e qeverisjes së mirë, rritjen e transparencës dhe forcimin e llogaridhënies publike, në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

BASHKËPUNIM BILATERAL DHE MBËSHTETJE TEKNIKE NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT TË MBRETËRISË SË BASHKUAR (NAO UK)



Zhvillimi i Kornizës së Komunikimit Strategjik dhe Përmirësimi i Funksioneve Kryesore të Komunikimit

Në vijim të bashkëpunimit bilateral ndërmjet Zyrës Kombëtare të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar (NAO UK) dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, me mbështetjen e Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD), në datat 13-15 janar 2026, u zhvillua në KLSH një takim 3-ditor pune me temë "Zhvillimi i Kornizës së Komunikimit Strategjik dhe Përmirësimi i Funksioneve Kryesore të Komunikimit". Mbështetja teknike u ofrua përmes sesioneve praktike, shkëmbimeve konkrete të eksperiencave dhe diskutimeve të hapura, ku ekspertët e NAO UK punuan me stafin e KLSH-së mbi kuadrin strategjik të komunikimit dhe funksionet kyçe të tij.








Në takimin me stafin e Drejtorisë së Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, z. Benjamin Peters, drejtor i Komunikimit me Jashtë në NAO UK dhe znj. Clare Harkey, drejtuese e Zyrës së Shtypit sollën eksperiencën se si Zyra Kombëtare e Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar komunikon me grupet e interesit për të përçarur qartë mesazhet e auditimeve, dhe rritur besimin dhe vlerën e punës së NAO-s. Ata theksuan se institucionet supreme të auditimit janë "rojtare" të fondeve publike që duhet të udhëhiqen nga tri parime kryesore: "Besimi, Vlera dhe Ndikimi". Z. Peters dhe znj. Harkey prezantuan edhe Strategjinë e re të Komunikimit të NAO-s deri në vitin 2030.



Gjatë trajnimit me stafin e KLSH-së, ekspertët e NAO-s veçuan rëndësinë e komunikimit efektiv që një Institucion Suprem Auditimi duhet të ketë me Parlamentin, punonjësit publikë, shoqërinë civile, median dhe qytetarët, për të forcuar ndikimin e mesazheve dhe rolin institucional në mbikëqyrjen e shpenzimeve të fondeve publike dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarët. Vizita rikonfirmoi angazhimin e përbashkët për cilësi, profesionalizëm dhe zhvillim institucional, si dhe vlerën e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve supreme të auditimit.

Falënderit për leximin!

© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH

 www.klsh.org.al	 Kontrolli i Lartë i Shtetit
 E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al	 klsh_org_al
 Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë	 (KLSH) Albanian Supreme Audit Institution
	 Orari pritjeve për publikun: E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30 E premte: 08:00 – 14:00